



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 95, datë 28.04.2022

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË ADMINISTRUESE TË FONDEVE TË PENSIONIT
“SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA” SH.A. EDHE SI SHOQËRI
ADMINISTRUESE E SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 17, të Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe nenit 7, të Rregullores nr. 112, datë 31.08.2020 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Shoqëria administruese e fondeve të pensionit “Sigal Life Uniqa Group Austria” sh.a. është shoqëri administruese e aseteve të fondeve të pensionit vullnetar dhe është licencuar me vendimin e Bordit të AMF-së nr. 50, datë 30.03.2011, me licencë nr. 2, datë 30.03.2011 dhe administron Fondin e Pensionit Vullnetar Sigal.

Në bazë të nenit 20, pika 2, të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, Autoriteti mund të lejojë që shoqëria administruese e fondeve të pensionit, të kryejë veprimtari administrimi të fondeve të investimeve, me kusht që shoqëria administruese të jetë e pajisur me licencën e duhur, për të kryer këtë veprimtari.

Shoqëria “Sigal Life Uniqa Group Austria” sh.a. ka paraqitur kërkesën për licencimin edhe si shoqëri administruese e fondeve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e licencimit të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit “Sigal Life Uniqa Group Austria” sh.a. edhe si shoqëri administruese e sipërmarrjeve të investimeve kolektive.**
- 2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, si dhe Drejtoria e Licencimit për njoftimet dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE